

BASHKOHUNI ME NE! T'I JAPIM FUND DHUNËS NDAJ GRAVE E VAJZAVE!



Kjo fletpalosje është hartuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (GADC) dhe Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN), në kuadrin e projektit “Ndërtimi i kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC-ve) për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve të lidhura me reduktimin e dhunës në baza gjinore dhe dhunës në familje të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020”. Projekti zbatohet nga GADC dhe AWEN në kuadër të programit rajonal kunder dhunës ndaj grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi ‘Zbatojmë Standartet, Ndryshojmë Mendësitë’, të zbatuar nga UN Women me mbështetjen financiare të Komisionit Evropian.

Përmbajtja e kësaj fletpalosje manuali është vetëm përgjegjësi e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim dhe Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri, dhe nuk reflekton opinionin e Komisionit Evropian dhe UN Women.



This programme is funded by the European Union

Zbatuar nga:



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



#MeDegJodheMua
FUND DHUNËS
NDAJ GRAVE
DHE VAJZAVE



Adresa:
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim:
TELEFONO PA PAGESË në numrin jeshil:
08001818

Adresa: Rr. “Abdyl Frashëri” P. 10/1, Ap. 3.
Tel: +355 4 22 555 14; ++355 4 22 555 15
E-mail: gadc@gadc.org.al

KJO FLETËPALOSJE PËRMBAN INFORMACION PËR ÇDO VAJZË APO GRUA QË NDIHET E DHUNUAR!

Ligji shqiptar ju mbron nga këto forma dhune:

- Dhunë të ushtruar në marrëdhëniet familjare (dhuna fizike, seksuale, psikologjike dhe ekonomike);
- Ngacmimin seksual;
- Dhunën seksuale, përfshirë përdhunimin;
- Martesat e detyruara, sidomos martesat e vajzave nën moshën 18 vjeç;
- Përndjekjen;
- Abortin e detyruar.

Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006

“Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”

merr në mbrojtje të gjithë anëtarët e familjes të cilët dhunohen nga pjesëtarët e familjes apo nga partneri/ ja intim/e. Dhuna në familje shfaqet në disa forma duke filluar nga DHUNA PSIKOLOGJIKE (e cila konsiston në bërtitje, fyerje, frikësim, kërcënime) që është forma më e shpeshtë e shfaqur; DHUNA FIZIKE (e cila shfaqet në formën e rrahjes, goditjes, pickimit, kafshimit, shtyrjes, mbyttjes, djegies, shkelmimeve etj.); DHUNA SEKSUALE (e cila ka të bëjë me detyrimin për të kryer marrëdhënie seksuale të padëshiruara nga ana e partnerit); DHUNA EKONOMIKE (e cila përfshin moslejimin për të përdorur rrogën, mosdhënien e parave për të blerë ushqim, ilaçe, pengimin e partnerit që të punojë, detyrimin me dhunë për tu larguar nga banesa, etj).

Duhet te dini se:

Ndalohet zgjidhja e rasteve të dhunës në familje me pajtim ose ndërmjetësim

**NËSE NDIHESH E KËRCËNUAR/
E PËRNDJEKUR MOS HEZITO!**

**TELEFONO NË NUMRAT E
MËPOSHTËM TË CILËT JU
PËRGJIGJEN NË ÇDO ÇDO ORË TË
DITËS DHE NATËS!**

POLICIA E SHTETIT – 112

URGJENCA MJEKESORE – 127

**LINJA KOMBËTARE E KËSHILLIMIT – 116117
(falas)**

Ju mund t'i drejtoheni gjithashtu:

- **Bashkisë tuaj apo Zyrës së njësisë administrative ku jetoni**
- **Deputetit/es tuaj në zonë**
- **Ndërlidhësit/es tuaj në komunitet**

Ju mund të telefononi në numrat:

Vlorë: Klinika ligjore: Cel: 0699333523 (24 orë) tel. 033224078; 033228048

Durrës: numër pa pagesë: 08009888; Cel: 052 234 600


Shkodër: Cel: 0035522241154

Cel: 00355693310172 (8.00-16.00, nga e hëna në të premte)

Elbasan: Cel: +355 69 65 11 674; +355 68 22 18 459

Tel: 0035554254516 (8.00-16.00, nga e hëna në të premte)

Korçë: Numri pa pagesë: 08003434 (8.00-16.00, nga e hëna në të premte)



ÇFARË DUHET TË BËJË VIKTIMA E DHUNËS NË FAMILJE APO NË MARRËDHËNIE INTIME

Në rast se përjetoni dhunë në familje, ose forma të tjera dhune të ushtruar nga persona jashtë familjes mund t'i drejtoheni stacionit të policisë më të afërt (të zonës ku banoni ose ndodheni), Njësisë përkatëse Vendore (komunë, bashki), Qendrës Shëndetësore të zonës ku banon apo ndodhet ose me kërkesë-padi gjykatës së rrethit të vendbanimit, vendndodhjes së saj apo të dhunuesit/es, për të marrë masat e nevojshme.

Këto institucione kanë detyrimin të marrin masa të menjëhershme për mbrojtjen tuaj, duke përfshirë urdhrin paraprak të mbrojtjes së menjëhershme (UPMM), të lëshuar nga punonjësi i Policisë së Shtetit ose struktura e Policisë së Shtetit si dhe urdhërin e mbrojtjes të lëshuar nga Gjykata. Autoritet e mësipërme kanë gjithashtu detyrimin t'ju informojnë dhe ofrojnë shërbime të tjera, si ndihmë mjekesore, këshillim psikosocial, ndihmë ligjore, strehim në strehizat e emergjencës gjatë kohës së rrezikut, etj.

Kundër dhunës në familje është ngritur

“Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të Dhunës në Familje” (MKR), i cili përbëhet nga institucionet përgjegjëse në nivel vendor dhe KA DETYRIMIN për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje.

DISA NGA INSTITUCIONET E MKR-SË JANË:

Policia e shtetit. Ka detyrimin të marrë masa të menjëhershme mbrojtëse për viktimën, asiston në plotësimin e Kërkesë- Padisë për Urdhrin e Menjëhershëm të Mbrojtjes drejtuar Gjykatës. Policia koordinon veprimet me Strehëzat apo Shërbimin Social për strehimin e menjëhershëm të viktimës së dhunës në familje dhe fëmijëve të saj, në rastet kur u kërcënohet jeta dhe shëndeti. Merr masa dhe vë para përgjegjësisë ligjore autorin/en e dhunës.

Bashkia

Ka detyrimin ta udhëzojë gruan ose vajzën që ndihet e dhunuar. Çdo bashki ka një koordinator vendor kundër dhunës në familje, i cili sipas rastit që i paraqitet bën referimin dhe jep zgjidhjen e duhur rastit të dhunës në familje.

Qendrat shëndetësore pranë njësive të qeverisjes vendore, kanë detyrimin të ofrojnë në çdo kohë ndihmë mjekësore për viktimat e dhunës në familje. Gjithashtu këto qendra kanë detyrimin t'ju pajisin me nje raport për dëmtimet që ju janë shkaktuar, të cilin mund ta përdorni si provë në Polici ose Gjykatë.

